

**REPUBLIKA E SHQIPERSISE**  
**SHOQERIA TREGETARE**  
**" INTERMEDICA CENTER " SH.P.K.**  
**T I R A N E**

**VENDIM NR 26, DATE 27.06.2018**  
**I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGTARE**  
**" INTERMEDICA CENTER " SH.P.K. TIRANE**

Ne Tirane, sot ne date 27, muaji Qershor, viti 2018, u mblodh Ortaku i vetem i Shoqerise Tregtare "INTERMEDICA CENTER" Sh.p.k. Tirane , ne seline e saj dhe mori ne shqyrtim rendin e dites :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2017 te mbyllura me 31 Dhjetor 2017 ;
- b) Zmadhimin e kapitalit aksionar te Shoqerise Tregtare "INTERMEDICA CENTER" Sh.p.k. Tirane.

Ortaku i Vetem ,z. Vasil LLAJO, pasi u njoh me rendin e dites

**VEREN SE :**

Shoqeria Tregtare "INTERMEDICA CENTER" Sh.p.k. Tirane, eshte e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit, date 06.03.2003, me ortak te vetem dhe administrator z. Vasil LLAJO.

Gjate shqyrtimit te veprimtarise tregtare dhe tregueseve financiare te shoqerise "INTERMEDICA CENTER" Sh.p.k. Tirane, Ortaku i Vetem konstaton se per per te patur nje vazhdimesi dhe siguri te veprimtarise, gjendjen e fitimeve te pa shperndara me 31 Dhjetor 2017 ti kaloje: 1) per zmadhim te kapitalit aksionar te kesaj shoqerie me vleren 57,000,000 Leke, 2) per shtim te rezervave ligjore 6,000,000 leke, dhe 3) diferenca prej 60,722,335 leke per shperndarje dividenti, ne baze te Statutit, Aktit te Themelimit dhe Ligjit "Per tregaret dhe shoqerite tregtare".

Per keto arsye,Ortaku i Vetem i Shoqerise Tregtare "INTERMEDICA CENTER" Sh.p.k. Tirane z. Vasil LLAJO, pas shqyrtimit te rendit te dites :

**V E N D O S I :**

- Miratimin e llogarive vjetore te Shoqerise Tregtare "INTERMEDICA CENTER" Sh.p.k. Tirane. per vitin financiar 2017 te mbyllur me date 31.12.2017;
- Kalimin e fitimeve te pashperndara gjendje sipas bilancit te mbyllur me 31 Dhjetor 2017 per: 1) zmadhimin e kapitalit aksionar te shoqerise me vleren 57,000,000 leke, 2) shtim te reserves ligjore me 6,000,000 leke , dhe 3) diferenca prej 60,722,335 leke per shperndarje dividenti, nga e cila do te derdhet ne buxhetin e shtetit brenda afatit ligjor tatimi mbi dividendin ne masen 15 % e barabarte me vleren 9,108,350 leke ;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anetar i Insitutit te Eksperteve Kontabel te Regjistruar, me Nr.Licence 97 date 10.01.2001, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit aksionar me fitimet e pa shperndara;
- Caktimin e z.Lavdimir FUSHA per auditimin e pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2018;
- Depozitimin e ketij vendimi prane Qendres Kombetare te Biznesit , si dhe Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane .

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE TREGETARE**

**"INTERMEDICA CENTER" SH.P.K TIRANE**

**VASIL LLAJO**

  
**INTERMEDICA CENTER SHPK**  
**Rr. JORDAN MISJA , TIRANE**  
**NIPT: K 31543084 W**  
**Tel: 22200600 FAX: 2234166**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**SHOQERIA TREGTARE**  
**"INTERMEDICA CENTER" SHPK**  
**T I R A N E**

---

**VENDIM NR. 27, datë 19.07.2018**  
**I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË TREGTARE**  
**"INTERMEDICA CENTER" SHPK TIRANE**

Në Tiranë, sot në datën 19, muaji Korrik, 2018, u mbledh Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Tregtare "INTERMEDICA CENTER" SHPK Tirane, në selinë e shoqërisë, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e fitimeve të pashpërndara për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 18 Korrik 2018 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Regjistruar;

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, z. Vasil LLAJO , pasi u njoh me rendin e ditës;

**V Ë R E N S E**

Shoqëria Tregtare "**INTERMEDICA CENTER" SHPK Tirane**, është regjistruar pranë Qendres Kombetare te Biznesit me date 06.03.2003.

Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie është z. Vasil LLAJO. Kapitali aksionar i kësaj shoqërie është 103,000,000 (Njëqind e tre milion) Lekë. Kështu, z. Vasil LLAJO zotëron 100 % të kapitalit aksionar, i barabartë ky me 100 (njëqind) kuota me vlerën 103,000,000 (Njëqind e tre milion) Lekë, ku secila kuotë ka vlerën prej 1,030,000 (Një milion e tridhjetë mijë) Lekë;

Me Vendimin Nr. 26, datë 27.06.2018, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka vendosur:

- Miratimin e llogarive vjetore te Shoqerise Tregtare "INTERMEDICA CENTER" Sh.p.k. Tirane. per vitin financiar 2017 te mbyllur me date 31.12.2017;
- Kalimin e fitimeve te pashperndara gjendje sipas bilancit te mbyllur me 31 Dhjetor 2017 per: 1) zmadhimin e kapitalit aksionar te shoqerise me vleren 57,000,000 leke, 2) shtim te reserves ligjore me 6,000,000 leke , dhe 3) diferenca prej 60,722,335 leke per shperndarje dividenti, nga e cila do te derdhet ne buxhetin e shtetit brenda afatit ligjor tatimi mbi dividendin ne masen 15 % e barabarte me vleren 9,108,350 leke ;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anetar i Insitutit te Eksperteve Kontabel te Regjistruar, me Nr.Licence 97 date 10.01.2001, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit aksionar me fitimet e pa shperndara;
- Caktimin e z.Lavdimir FUSHA per auditimin e pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2018;
- Depozitimin e ketij vendimi prane Qendres Kombetare te Biznesit , si dhe Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane .

Në vështrim të rendit të ditës, Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e fitimeve të pashpërndara për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 18 Korrik 2018, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Regjistruar z. Lavdimir FUSHA, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar.

  
**INTERMEDICA CENTER SHPK**  
Rr. JORDAN MISJA, TIRANË  
NIPT: K 34543084 W  
Tel: 22200600 FAX: 2234168

Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit aksionar të shoqërisë bëhet nga 103,000,000 (Njeqind e tre milion) Leke ne 160,000,000 (Njeqind e gjashtedhete milion) Leke, e barabartë kjo me 100 (Njeqind) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 1,600,000 (Nje milion e gjashteqind mije) Lekë. Pra, numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit aksionar mbetet i pandryshueshëm dhe vetëm vlera nominale e tyre rritet.

Ky kapital do të zotërohet nga Ortaku i Vetëm në këtë mënyrë:

**z. VASIL LLAJO**, do të jetë përsëri zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 100 (njeqind) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 1,600,000 (Nje milion e gjashteqind mije) Lekë.

Për këto arsye, Ortaku i Vetëm, pas shqyrtimit të rendit të ditës;

### V E N D O S I

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit per vleresimin e fitimeve te pashperndara per zmadhimin e Kapitalit Aksionar te Shoqerise te dates 18 Korrik 2018 te pergatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabel i Regjistruar;
2. Zmadhimin e Kapitalit Aksionar te kesaj shoqerie nga 103,000,000 (Njeqind e tre milion) Leke ne 160,000,000 (Njeqind e gjashtedhete milion) Leke, e barabarte kjo me 100 (Njeqind) kuota (pjesë) kapitali;
3. Numri i kuotave (pjesëve) te kapitalit, mbetet i pandryshueshem, dhe rritet vetem vlera nominale e tyre;
4. Vlera e cdo kuote (pjesë) kapitali kalon nga 1,030,000 (Nje milion e tridhete mije) Leke ne 1,600,000 (Nje milion e gjasteqind mije) Leke ;
5. **z. VASIL LLAJO**, do te jete perseri zoteruese i 100 % te kuotave te kapitalit aksionar, i cili do te perbehet nga 100 (Njeqind) kuota (pjesë) kapitali ku secila kuote (pjesë) do te kete vleren nominale prej 1,600,000 (Nje milion e gjashteqind mije) Leke ;
6. Depozitimim e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare te Biznesit .

### ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË TREGTARE

**"INTERMEDICA CENTER" SHPK TIRANE**

**VASIL LLAJO**

*Vasil LLAJO*  
**INTERMEDICA CENTER SHPK**  
Rr. JORDAN MISJA, TIRANË  
NIPT: K 31513084 W  
Tel: 22200600 FAX: 2234166